

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Hashim Çollaku, kryetar, Shqipe Qerimi e Feerit Osmani, anëtarë, me bashkëpunorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale të të akuzuarit S.G. nga fshati ..., komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale shkelje e Urdhërit mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, nr. 03/L-182, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1612/2016 datë 29.08.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 02.02.2017, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me aprovimin e ankesës së Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, P.nr.1612/2016 datë 29.08.2016, ndryshohet vetëm sa i përket vendimit për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpall fajtor i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) €, të cilin dënim duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, e në rast se dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burg, në atë mënyrë që për çdo 20€, të dënimit me gjobë do t'i caktohet nga një ditë burgim.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, me aktgjykimin P.nr.1612/2016 datë 29.08.2016, të akuzuarin S.G., e ka shpallur fajtor për veprën penale shkelje e Urdhërit mbrojtës nga neni 25 i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje, nr. 03/L-182, për të cilën e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 200 dyqind) €, të cilin dënim ka për ta paguar në afatin prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, e në rast se dënimi me gjobë nuk paguhet në afatin ligjor, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burg, në atë mënyrë që për çdo 20€, të dënimit me gjobë do t'i caktohet nga një ditë burgim. E dëmtuara, N.G. nga fshati ..., komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil. Është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20€ në afatin prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren vetëm për shkak të vendimit për dënim, me propozim që ankesa të aprovohet, aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me gjobë në lartësi më së paku 400€.

Prokurori i Apelit i Kosovës, me shkresën PPA/II.nr.1532/2016, datë 08.12.2016, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi i kundërshtuar të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënimin dhe të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i lartë.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se

Ankesa është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk kundërshtohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPP dhe konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij dhe as shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 29.08.2016 e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par.2 të KPPK-së, ndaj aktgjyqimit që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore.

Prokurori Themelor në ankesë ka theksuar se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është tejet i butë dhe i mangët, pasi që gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit ka marrë për bazë vetëm rrethanat lehtësuese dhe atë pranimin e fajësisë, deklaratën e të akuzuarit se do të mundohet që problemet me të dëmtuarën ti zgjidhë në atë mënyrë që do të ndërtojë një shtëpi të veçantë për te e të jetojnë ndarazi, se i akuzuari është njeri familjar, nuk ka pasur probleme me ligjin, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, ndërsa rrethana rënduese nuk ka gjetur.

Sa i përket vendimit mbi dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit janë të bazuara, rrethanat lehtësuese janë mbivlerësuar ndërsa dënimi me gjobë i shqiptuar në rastin konkret është tejet i butë dhe nuk është adekuat me rrezikshmërinë dhe rrethanat e veprës penale dhe se me dënimin e shqiptuar nuk do të arrihet qëllimi dhe efekti i dënimit.

Kjo Gjykatë duke pasur parasysh peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, mënyrën e kryerjes së veprës penale, faktin se e dëmtuara është familjare e tij respektivisht grua e axhës dhe teze e në veçanti duke vlerësuar faktin se për shkak të mosmarrveshjeve që i akuzuari ka pasur me të dëmtuarën Nafije dhe familjaren e saj, nga gjykata është lëshuar Urdhëri për mbrojtje C.nr. 506/2016 i datës 23.05.2016, konsideron se me dënimin e shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë nuk do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj në këtë drejtim Gjykata e Apelit ndryshoi aktgjykimin e kundërshtuar përkitazi me vendimin mbi dënimin, duke ia ashpërsuar dënimin të akuzuarit dhe duke i shqiptuar dënimin me gjobë në shumë prej 500(pesëqind) €, me bindje se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe adekuat me përgjegjësinë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit- preventiva individuale dhe ajo e përgjithshme.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
PA1.nr. 1500/2016, me 02.02.2017

Bashkëpunëtori profesional,  
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit,  
1.Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit  
2. Shqipe Qerimi  
3. Ferit Osmani